



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 1406/12 Prot. Datë 23.2.2024



Nr. 871/11 Prot. Datë 23.02.2024

MARRËVESHJE

PËR

OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËR PËRFITUESIT E KARTËS SË STUDENTIT, DELEGIMIN DHE ADMINISTRIMIN E KARTËS SË STUDENTIT NGA BASHKIA ELBASAN

Kjo marrëveshje lidhur sot, më datë ___/02/2024, ndërmjet palëve të mëposhtme:

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me adresë: "Rruga e Durrësit, Nr. 23, Tiranë, Shqipëri, më poshtë referuar si "**Ministria**", përfaqësuar nga **Znj. Ogerta Manastirliu**, Ministër,

dhe

Bashkia e Elbasanit, me adresë: Rruga "Qemal Stafa", sheshi "Aqif Pasha", Elbasan, Shqipëri më poshtë referuar si "**Bashkia**", përfaqësuar nga **Z. Gledian Llatja**, Kryetar i Bashkisë,

në vijim të njohur individualisht si "**Pala**" dhe së bashku "**Palët**".

DUKE QENË SE:

- Me propozim të ministrit të Arsimit dhe Sportit, është miratuar vendimi, nr. 226, datë 17.04.2019, i Këshillit të Ministrave, "*Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit*".

- Në vendimin nr. 226, datë 17.04.2019, të Këshillit të Ministrave, përcaktohet se në nivel vendor, marrëveshjet për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit nënshkruhen ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe Bashkia ka paraqitur kërkesë për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit, për studentët që studiojnë në territorin nën juridiksionin e saj.
- Ministria ka miratuar udhëzimin nr. 14, datë 27.05.2019, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit”.
- Bashkia në vijim të nismave dhe iniciativave të ndërmarra në kuadër të Paktit për Universitetin, ka paraqitur kërkesën për t’u angazhuar në procesin e përgatitjes dhe lëshimit të Kartës së Studentit në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore.
- Ministria njeh kontributin dhe angazhimin aktiv të Bashkisë në çështjet sociale dhe të arsimit dhe vlerëson krijimin e një partneriteti serioz me këtë të fundit për përgatitjen dhe lëshimin e Kartës së Studentit sipas kushteve dhe termave të parashikuara në këtë Marrëveshje.

Palët, në konsiderim të kushteve paraprake si më sipër ranë dakord me njëra-tjetrën për sa më poshtë vijon:

Neni 1 Përkufizime

- 1.1 “**IAL**”, është institucion i arsimit të lartë, që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe/ose profesionale në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan.
- 1.2 “**Karta e Studentit**”, është dokument unik identifikues që i shërben studentit për të përfituar shërbime me çmime të reduktuara nga entet shtetërore në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes.
- 1.3 “**Student**”, është çdo individ që gëzon statusin e studentit të regjistruar pranë institucioneve të arsimit të lartë që ushtojnë veprimtari në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan.
- 1.4 “**Shërbime**”, do të ketë kuptimin e shërbimeve apo produkteve të ofruara me çmime të reduktuara dhe/ose falas nga entet shtetërore në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes, etj.

Neni 2

Baza ligjore e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje lidhet në bazë të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, vendimit nr. 226, datë 17.04.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen më çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që parashikojnë këtë veprimtari.

Neni 3

Objekti dhe Qëllimi i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i shërbimeve me çmime të reduktuara që do të ofrohen për studentët nëpërmjet Kartës së Studentit nga Bashkia dhe delegimi i të drejtës nga Ministria me anë të kësaj Marrëveshje Bashkisë për prodhimin dhe administrimin e Kartës së Studentit, sipas kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Qëllimi i Marrëveshjes është prodhimi dhe administrimin e Kartës së Studentit nga Bashkia, sipas kërkesës së saj dhe përdorimi nga studenti i Kartës së Studentit në përputhje me rregullat e zbatueshme, me qëllim përfitimin e shërbimeve me çmime të reduktuara dhe/ose falas brenda territorit nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan.

Neni 4

Lëshimi dhe përfitimi i Kartës së Studentit

4.1 Me anë të kësaj Marrëveshje, Ministria i akordon Bashkisë të drejtën për prodhimin dhe administrimin e Kartës së Studentit, nëpërmjet së cilës do të aktivizohen dhe përfitohen të gjitha funksionet dhe shërbimet e vëna në dispozicion në kuadër të programit të Kartës së Studentit, sipas aneksit 1, Programi “Karta e Studentit”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshje.

4.2 Karta e Studentit e cila do të përgatitet nën përgjegjësinë e Bashkisë do të ofrohet pa pagesë për të gjithë studentët e IAL-së që ushtrojnë veprimtari në territorin nën juridiksionin e saj, të cilët duhet të paraqiten dhe aplikojnë personalisht pranë IAL-së përkatëse. Çdo student duhet të plotësojë dhe dorëzojë formularin përkatës të vetëdeklarimit.

4.3 Pas verifikimit në sistem të të dhënave të studentit të depozituara sipas procedurës së përshkruar në pikën 4.2, karta printohet/krijohet dhe tërhiqet pranë IAL-së nga secili student

personalisht. Karta e Studentit identifikon mbajtësin e saj si student i institucionit përkatës i arsimit të lartë dhe i akordon të drejtën e përfitimit të shërbimeve të programit të Kartës së Studentit.

4.4 Studentët kanë të drejtë të pajisen me kartë studenti sipas përcaktimeve të udhëzimit të ministrit përgjegjës për arsimin për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit, deri në marrjen e diplomës së ciklit përkatës së studimit apo nëse humbet statusin e studentit. Në rast dëmtimi apo kur studentit e humbet atë, studentit ka të drejtë të riaplikojë për një kartë të re, e cila lëshohet me të njëjtin afat vlefshmërie sa karta e mëparshme.

4.5 Gjatë gjithë periudhës së studimeve, çdo student i pajisur me kartë studenti ka të drejtë të përfitojë shërbime dhe/ose produkte me çmime të reduktuara dhe/ose falas të ofruara nga Bashkia apo institucione të tjera publike dhe partnerë të tjerë të cilët mund të bëhen pjesë e programit “Karta e Studentit” në të ardhmen.

4.6 Me pezullimin apo largimin e studentit nga IAL-ja, sekretaria e IAL-së përkatëse do i tërheqë studentit kartën e lëshuar dhe do të kryejë brenda ditës procedurat e çregjistrimit, me qëllim asgjësimin e saj.

Neni 5 **Angazhimet e Palëve**

5.1 Bashkia, apo subjektet e kontraktuara prej saj, merr përsipër të realizojë, përgatisë dhe lëshojë Kartën e Studentit.

5.2 Bashkia me burimet financiare të saj do të sigurojë pajisjen e IAL-së me bazën materiale të nevojshme sipas rregullave ligjore në bazë të numrit të studentëve të regjistruar dhe trajnimin e personelit të dedikuar që do punojnë për kryerjen e këtij procesi. Bashkia, apo subjektet e kontraktuara prej saj, merr përsipër të kontraktojnë studentë të IAL-së përkatëse si të punësuar me kohë të pjesshme, për realizimin e përgatitjes dhe lëshimit të kartës.

5.3 Palët në bashkëpunim me njëra-tjetrën do të krijojnë një sistem të përbashkët për regjistrimin e studentëve që do të pajisen me kartë dhe menaxhimin e efektivitetit të kartës së lëshuar.

5.4 Për realizimin e këtij projekti, Ministria merr përsipër të angazhojë në veçanti me pjesëmarrje operative IAL-në që ushtron veprimtari në territorin nën juridiksionin e Bashkisë. Palët marrin përsipër krijimin e një rrjeti bashkëpunimi për realizimin e qëllimeve të përbashkëta për krijimin e një sistemi në bazë të së cilit në bazë të mbështetjes operative të IAL-së, Bashkia do të pajisë me kartë të gjithë studentët e regjistruar.

5.5 Bashkia merr përsipër të prodhojë kartën e studentit në përputhje me procedurat, specifikimet teknike dhe standardet e parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi.

5.6 Baza e të dhënave që krijohet gjatë procesit të pajisjes me Kartën e Studentit administrohet nga ministria përgjegjëse për arsimin përmes Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Bashkia merr përsipër mbulimin e të gjitha shpenzimeve për prodhimin dhe administrimin e kartës së studentit nga burimet e veta dhe krijimin e bazës së të dhënave, bazë e cila i vihet në dispozicion MAS dhe QSHA nëpërmjet krijimit të aksesit të përhershëm ashtu dhe transferimit të të dhënave në mënyrë të vazhdueshme.

5.7 Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje palët angazhohen në promovimin e projektit në tërësi në lidhje me kushtet e përdorimit të Kartës së Studentit, përfitimet dhe çdo aspekt tjetër që ka lidhje me të.

5.8 Palët do të miratojnë çdo iniciativë të dobishme për të promovuar pajisjen me kartë dhe publikojnë çdo informacion në dispozicion në lidhje me rrjetin e mallrave dhe shërbimeve të aktivizuara që do të përfitohen në kuadër të këtij projekti nga organet ose entitetet publike.

Neni 6

Hyrja në fuqi dhe përfundimi

6.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe do të qëndrojë në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

6.2 Kjo marrëveshje mund të përfundohet në çdo kohë nga secila prej palëve, duke dhënë njoftim me shkrim nga njëra Palë tek tjetra, 3 (tre) muaj përpara datës së përfundimit.

Neni 7

Mbrojtja e të dhënave

7.1 Palët do të trajtojnë çdo informacion, të dhënë personale dhe të ndjeshme në lidhje me studentët si informacion konfidencial.

7.2 Palët duhet të respektojnë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe me përpunimin e tyre.

Neni 8

Dispozitat e fundit

8.1 Kushtet paraprake ashtu si dhe aneksi 1, Programi “Karta e Studentit” bashkëngjitur, janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

8.2 Asnjë shtesë, modifikim ose amendament i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë detyrues përveçse në rast se ai do të bëhet me shkrim dhe do të jetë i nënshkruar rregullisht prej Palëve.

8.3 Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të barasvlershme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë.

PALËT

Ministria e Arsimit dhe Sportit

MINISTRI

Znj. Ogerta Manastirliu



Bashkia Elbasan

KRYETARI

Z. Gledian Llatja

